



# ANALIZA VJETORE 2011

( Mbi veprimtarine e administrates se Bashkise për vitin 2011 )

Janar 2012

## ***Te nderuar pjesemarrës !***

Takimi i sotem ka si objekt, te trajtoje ne menyre analitike veprimtarine e administrates Bashkise Lezhe, per vitin 2011 dhe konkretisht :

- a. Si jane realizuar detyrat dhe objektivat e parashikura, per vitin 2011 ne nivelin e drejtimit dhe organizimit ne funksion te zhvillimeve ekonomike, hartimin dhe zbatimin e projekteve te zhvillimit ne infrastrukturen publike dhe permiresimin e sherbimeve ndja komunitetit qytetar etj.
- b. Gjithashtu do te njihemi ne vija te pergjithshme me mangesite e verejtura ne punen e kesaj administrate, me problematiken me te cilen eshte ndeshur gjate vitit 2011 kjo administrate etj;
- c. Ndersa ne fund te kesaj analize do te njihemi me disa nga objektivat kryesore te vitit 2012 si nje vit Jubilar i 100 vjetorit te Pavaresise Kombetare dhe formimit te shtetit Shqipetar.

Viti qe sapo mbyllem ka qene një vit i veçante, per administraten e Bashkise dhe gjithë komunitetin lezhjan, sepse ishte viti i bilancit te arritjeve katervjeçare, te mandatuar nga zgjedhjet e 18 shkurtit 2007. Vit ne te cilin Kryetari i Bashkise dhe administrata e kesaj bashkie, doli ne komunitet per te informuar çdo banor te ketij qyteti nepermes medias lokale e publike dhe takimeve direkte, per t'i thene çfare kemi bërë ne kater vite dhe çfare nuk kemi arritur te bëjme, ndonese vullneti dhe deshira jone ka qene per me shume.

Ky ballaqim dhe kjo praktike publike, u vleresu nga komuniteti lezhjan i cili na votëbesoj, per nje mandat tjeter katervjeçar, te cilin sapo e kemi filluar.

Ky votëbesim eshte jo vetem vleresim i punes se kater viteve te shkuara, qe kjo administrate ne bashkepunim me gjithë faktoret e tjere ka realizuar, por eshte njekohesisht nje obligim me permasa akoma me te medha ndaj ketij komuniteti vlerësues dhe besues, siç eshte komuniteti lezhjan. Ndaj detyrat tona ne vitin 2012 e ne vazhdim kerkojne nje seriozitet dhe angazhim maksimal, ne sherbim te ketij komuniteti, me qellim qe me punen tone dhe zgjidhjet qe do japim, te krijojme besueshmerine qytetarit dhe premisa per nje jete me mire, per nje qytet me te bukur dhe te paster, me institucione arsimore dhe kulturore me cilesore ne sherbim te banoreve dhe femijeve te ketij komuniteti.

- Kjo do jete motoja e punes sone dhe
- Ky do jete objektivi Yne.

## ***Te nderuar pjesemarrës !***

Viti 2011 qe sapo kemi mbyllur ishte nje vit per t'u mbajtur mend ne kujtesen e gjithsecilit, jo vetem per faktin se kishte nje fillim mjaft tragjik siç ishin permbytjet me pasoja te medha te muajit janar dhe ngajrjen e 21 janarit, por per faktin se bashkia Lezhe krijoj disa premisa cilesore ne sherbim te komunitetit siç mund t'i evidentojme :

- Si nje vit ne te cilin Bashkia mundesoj zgjidhje te rendesishme, per komunitetin, ne aspektin e permiresimit te infrastruktures publike si nepermes investime

direkte nga grandit e Qeverisë Shqiptare, nga të ardhurat vendore dhe nga një praktikë e Re si ajo e Kredës me Bankën Raiffeisen;

- Që përballuam një vështirësi të lidhura me krizën ekonomike mbarëbotërore, krizë e cila ka lënë një pasojë dhe vazhdojnë akoma të mbeten ndikimet e saj në ekonominë shqiptare dhe atë të bashkisë Lezhë.
- Që realizuam kërkesat dhe objektivat e vëna në analizën e vitit 2010, të një viti elektorale siç ishte viti 2011;
- Realizuam të mënyrë të pranueshme të ardhurat nga taksat dhe tatimet në masën 74 % ,
- Që filluan investime me vlerë të konsiderueshme dhe të pa realizuara ndonjëherë në qytetin tonë, në të gjitha lagjet e qytetit, të financuara nga grandit e qeverisë, kredia e bankës dhe të ardhurat vendore, ndër të cilat mund të përmendim:
  - a. Ndërtimi i rrugës Kalasë;
  - b. Ndërtimi i rrugës dytesore të Spitalit,
  - c. Ndërtimi i rrugës në bllokun 11,2 ha lagje Beslidhja,
  - d. Ndërtimin e shkollës mesme të qytetit;
  - e. Rikonstruksioni i lagjes Gurra,
  - f. Rikonstruksioni i lagjes Spitalit,
  - g. “ ” i lagjes “Nënë Tereza”;
  - h. Sistemit e bllokut në bregun e lumit Drin - lagje “Beslidhja”.
  - i. Rikonstruksioni i rrugës tek shkolla “Gj. Fishta”; etj.
- Përfunduam hartimin e Planit të Përgjithshëm Rregullues të qytetit dhe jemi në fazën e përshatshmerisë me ligjin e Ri “Për Planifikimin e Territorit”;
- U përmirësuan raportet e bashkëpunimit me donator të huaj, për financimin e projekteve në funksion të institucioneve arsimore dhe shërbimeve publike;
- Realizuam shtimin e bimeve dekorative dhe përmirësimin e zonave të gjelbërta në blloqet e banimit dhe akset e rrugëve të qytetit.
- Që më së mëtejshme një serioze, për reformimin e administratës së Bashkisë, nëpërmjet konkurimit të vlerave dhe aftësive profesionale, për të krijuar një administratë cilësore, të kualifikuar dhe stabile ndaj ndryshimeve politike.
- Që më së mëtejshme një projekt për kushtëzimin e ndihmës ekonomike nëpërmjet “Punës dhe shërbimeve në komunitet”, projektet sociale të perkujdesjes për moshën e tretë, për femijet Rom, familjet në nevojë etj.
- U përmirësuan shërbimet ndaj komunitetit qytetar dhe atij të biznesit, me rritjen e gatishmerisë dhe cilësive të shërbimit nga Zyra për “Marrëdhënie me Publikun”, “Qendra Kombëtare e Rregjistrimit“(QKR-ja), shërbimi “Gjendjes civile”, zyra e “Prodhimit të pasaportave biometrike”, në sektorin e shërbimeve publike etj.
- Janë evidentuar indikatorët e zhvillimit dhe jemi në fazën përfundimtare të rivlerësimit të “Strategjisë së Zhvillimit Afatmesëm”, për periudhën 2012 - 2020.
- Po krijohet një traditë e re në promovimin e vlerave kulturore, historike dhe arkeologjike të qytetit të Lezhës, për rritjen e interesit të vizitorëve vendas dhe të huaj, në funksion të zhvillimit të “Turizmit Kulturor”.
- U zhvilluan një veprimtari kulturore, artistike dhe promovuese në funksion të arzetimit të qytetarëve, në përgjigje të kërkesave të intelektualëve, të grupmoshave të ndryshme, etj.

- Krahas ruajtjes se tradites ne perkujtim te festave, ngarjeve historike e kulturore te qytetit, u arrit te riciklohen ata festa te reja si "Nata e Bardhe e Kultures Shqipetare", "Dita e Emigrantit" te cilat po behen pjese e kultures dhe tradites se re ne qytetin tone.
- Vemendje e veçante eshte kushtuar raporteve te partneritetit me Keshillin e Bashkise, konform detyrimeve ligjore, duke qene gjithnje koherent dhe cilesor ne vleresimin e kerkesave dhe detyrimeve ndaj tij si organ vendimmarres. Keshtu per vitin 2011 evidentohet nje bashkepunim mjaft frytdhenes, i cili prodhoj 100 vendime ne harkun kohor te një viti.

***Cilat ish-in disa nga drejtimet kryesore të punës ne administraten e Bashkise, për vitin 2011 dhe si janë realizuar ata ?!***

Ne administraten e bashkise gjate vitit 2011 kane funksionuar 9 drejtori dhe 5 sektorë me nje administrate prej 65 veta, perfshire edhe funksionet e deleguara (Gjendja Civile & QKR-ja) dhe 6 institucione vartese.

Ne gjithe aktivitetin e vitit 2011 nga pun onjesit e administrates dhe institucioneve vartese eshte punuar me objektiva konkrete afatshkurter dhe afatmesem, per te mundesuar realizimin e detyrave te vitit dhe per krijuar premisat, per nje pune ne vazhdimësi.

E vleresaur ne kete kendveshtrim, mund te evidentojme rezultatin e punes te çdo sektori gjate vitit 2011 dhe konkretisht :

**DREJTORIA E TE ARDHURAVE :**

***Ka patur si mision :***

1. Regjistrimin e vazhdueshem dhe menaxhimin e subjekteve të tatueshme, ndjekjen e politikave programore dhe strategjitë implementuese mbi licencimin e rrjetit të biznesit në qytetin e Lezhës ne veprimtarine gjithëvjetoje;
2. Perditësimin e database të të gjitha subjekteve tregtare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytetin e Lezhës te regjistruara ne organet tatimore;
3. Ushtrimin e kontrolleve efikase ne rrjetin e tregëtisë se qytetit me objekt realizimin e te ardhurave fiskale, planifikuar per vitin 2011.

***Cili ka qene realizimi i detyrave te vitit 2010 nga kjo drejtori :***

Në zbatim te ligjit "Për sistemin e taksave vendore" dhe vendimin e Keshillit Bashkise "Për miratimin e nivelit të taksave e tarifave vendore të vitit 2011" ne punen e drejtorise se te "Ardhurave Vendore" ka dominuar tendenca, per bashkepunim te vazhdueshem me komunitetin e bizmesit, per realizimin e te ardhurave te buxhetit te planifikuar per vitin buxhetor.

Nga **135.050 mijë lekë** të ardhura të planifikuara nga taksat për vitin 2011, janë realizuar **115.536 mijë lekë**, ose **85,55% e planit**. Ndërsa krahasuar kjo me realizimin e një viti më parë (2010), kemi arkëtuar **19.965 mijë lekë më shumë** të ardhura.

Nderkohe, **realizimi i të ardhurave jotatimore** nuk ka qene në nivele të pranueshme, pasi paraqitet me një realizim në masën e 26.024 mijë lekë ose 46,19 %. **Nga 56.347 mijë lekë të planifikuara, jane realizuar 30.323 mijë lekë më pak se plani.**

Pra në **total** kemi një mosrealizim të planit të të ardhurave për vitin 2011, në vlerën e 26%, e përkthyer në vlerën e 49.837 mijë lekë.

Nga analiza e mosrealizimit të të ardhurave konstatojmë se mos realizimet janë kryesisht tek disa taksa me axhent tatimor institucionet jashte Bashkise dhe nga tarifat vendore, nder te cilat evidentojme :

- Pastrimi dhe largimi i mbeturineve, eshte realizuar në masen 42,22%,
- Dhënie leje, Liçenca e Autorizime jane realizuar në masen 24.%,
- Taksa mbi pasuritë e paluejtëshme me agjent tatimor – Z.Rr.P.P – Lezhë eshte realizuar ne masen 59 %;
- Taksa e rregjistrimit te mjeteve te transportit me agjent tatimor Drejtorine e mjeteve te transportit Laç eshtë realizuar në masën 88% etj..

Mosrealizimet në të ardhurat jotatimore nga tarifa e pastrimit, në vlerën prej 10.111 mijë lekë i përket, kryesisht, mosarkëtimeve nga abonentët familjarë Per vitin qe po analizojme,pagesa e tarifes pastrimit nga qytetaret eshte ne nivele minimale dhe qe nuk mbulojne as gjysmen e kostos te ketij sherbimi. Ketu nuk ka ndikuar vetem ndergjegjesimi i pamjaftushem i gjithe qytetareve, por edhe shkaqe te tjera objective e subjective; si mungesa e adresave te sakta, mos njohja ne kohe me kete detyrim etj.

Per vitin 2012, si rrjedhoj edhe i permiresimit cilesore te ketij sherbimi, te ardhurat nga kjo tarife edhe rritur dhe ambicja per mbledhjen e saj do jete me e madhe. Me masat qe kemi marre e po merren fillimi i punes ne kete drejtim eshte premtus, Per muajin janar te ketij viti jane arketuar, aq sa eshte arketuar gjate 3 mujorit te pare ne vitin e kaluar. Gjithashtu po studjohet mundesia e organizimit me agjent tatimore, gje qe per mendimin tone do permiresoj shume punen per realizimin e ketij tregusi.

Vlera prej 5.347 mijë lekë i përket mosrealizimit të zërit financime nga donatorët, pasi, sic dihet, marrveshjet u lidhen ne muajet e fundit te vitit dhe per rrjedhoj edhe objektet u filluan me vones dhe financimi i tyre nuk u krye brenda vitit. Por kjo vlerë padyshim që do realizohet brenda dy mujorit të parë të vitit 2012, (investimi nga **dldp**, për qendren e perpunimit te mbetjeve). Krahas tyre, bashkia ka perfituar dhe do perfitoj projekte te tjera me bashkefinancim fondeve te tjera nga donator te ndryshem, per rrethimin e ambientit shkollave etj..

Mosrealizime te te ardhurave patem edhe nga zëri të tjera, si tarifa e parkimit të automjeteve, bileta hyrje në stadium, te ardhurat per sherbimet administrative, të ardhura nga tarifat urbanistike, etj. Ato jane analizuar me hodhesi ne drejtorite perkatese dhe jane programue masa konkrete, qe kete vit te behen permiresimet e nevojeshme.

Ne kemi bindjen e plote se me masat qe kemi marre ; organizimin me te mire te punes ne kete drejtori, reforma qe beme, duke vendos specialist sipas meritave, si edhe mbeshtejta qe po i japim; per kete vit, realizimi i te ardhurave do jete shume me i mire.

## DREJTORIA E FINANCES :

### **Ka patur si objektiv kryesore :**

1. Ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të gjendjes financiare dhe ushtrimin e kompetencave në zbatim të efektivitetit ekonomik dhe drejtimit financiar.
2. Hartimin e treguesve të buxhetit, miratimin në keshillin e Bashkise dhe ndjekjen e realizimit të tij, për vitin buxhetor.
3. Ushtrimin e kompetencave në zbatimin e parimeve të efektivitetit ekonomik dhe drejtimit financiar, për të ruajtur të balancuar të ardhurat me shpenzimet administrative.
4. Ndjekjen në mënyrë permanente të situatës ekonomike dhe prezantimi i nevojave, për ndryshime të mundshme në buxhetin e vitit, për të ruajtur ekuilibrat financiar të Bashkise. etj.

### **Cilët janë disa nga treguesit financiar kryesor të vitit 2011 :**

Në buxhetin e vitit 2011 janë planifikuar të ardhura nga taksat, tarifat dhe aktiviteti ekonomik i Bashkise **135 050 mijë leke**, ndërsa realizimi ka qenë **115 536 mijë leke** ose **85,55 %** e planit;

- **Fondi i pagave** - planifikuar 71 721 mijë leke, realizuar 69 973 mijë leke ose 97 %.
- **Shpenzime operative** - planifikuar 69 582 mijë lekë; realizuar 60 662 mijë leke ose 87 %.
- **Investimet** - planifikuar 107 016 mijë leke; realizuar 54 372 mijë leke ose 50 %.
- **Sherbime me kontrate** - planifikuar 46 500 mijë leke; realizuar 32 303 mijë leke ose 70 %.

Shpenzimet buxhetore në total, për vitin 2011, u realizuan vetëm 71 % duke krijuar një deficit buxhetor prej 90 970 mijë leke.

Viti 2011, si një vit elektoral ishte një vit i vështirë financiar; jo vetëm për këtë fakt, por edhe për mjaft shkaqe të tjera objektive e subjektive. Duhet pranuar se efekti i krizës në rajon ka ndikuar edhe në bizneset e qytetit tonë, për rrjedhim edhe në realizimin e buxhetit të Bashkise. Gjate vitit në patëm edhe një paksim të transfertes pakushtezuar me rreth 2 milion leke.

Megjithatë, gjendja financiare dhe aftësia paguese ka qenë relativisht e mirë. Kjo fal masave që kemi marrë, **se pari** për të kompesuar mungesën e të ardhurave me burime tjera, dhe **se dyti**, për një administrim sa më të mirë të shpenzimeve.

Mbi bazën e një studimi dhe analize, mundësiam plotësimin e disa kërkesave me leje ndërtimi. Përveç tjerash, kjo ndikoi në rritjen e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe permiresoj mjaft gjendjes financiare.

Nga ana tjetër, gjate vitit kaluar, kemi kursyer mjaft nga shpenzimet e parashikuara; Fondi për dietat e shërbimeve është realizuar vetëm 50 përqind.

Përveç shpërblimit prej 10 mijë leke për person para vitit ri, nuk është paguar asnjë shpërblim tjetër.

Fondi i vecant është realizuar vetëm 20 përqind e planifikimit.

Fondi rezervë është përdorë 15 përqind e planit dhe vetëm për raste shumë të argumentuar.

Jane paguar rregullisht pagesat, sipas buxhetit miratuar, nderkohe qe disa vende pune te paplotesuar ne organike, qe jan gjykuar, kane mbetur pa u plotesua.

Megjithe punen e perpjekjet qe kemi bere, mosrealizimet jane te medha, sidomos ne financimin e investimeve, ku edhe deficitit eshte me i madh.

**Mosrealizimi i investimeve vjen kryesisht nga;**

- nivelin e realizimit te te ardhurave
- mosrealizimi i grafikut punimeve nga disa sipermarres ndaj te cileve bashkia ka marre e po merre masa sipas kushteve te kontrates;
- mungesa e disbursimit te kredise sipas nevojave dhe ecurise se punimeve ne objektet qe financohen me kredi..

Gjate vitit 2011, bashkia ka ndjekur e financuar investime madhore, qe kane filluar kete vit ose jan ne vazhdim me vietet e kaluara. Jane realizuar 261 257 mije leke investime me fonde te Bankes Boterore dhe me buxhetin e shtetit, si; ndertimi i shkollave te qytetit, perfundimi i rruges lagjen N. Tereza, e lagjen Liria, fillimi i punes per ndertimin e rruges Spitalit, shpronosim trualli per nevoja publike etj. Fondet e celura nga keto burime jane perdorur 100 perqind e fondeve te vena ne dispozicion per vitin 2011.

Projekt buxheti i vitit 2012 edhte ne fazen e diskutimit dhe miratimit ne Keshillin Bashkiak. Objektivat qe parashikojme te realizojme jane shume me te medha se ato te vitit kaluar. Kjo kerkon nje impenjim me te madh dhe nje bashkepunim me te mire, si ndermjet drejtorive, ashtu edhe me komunitetin e biznesit.

Vitin 2012 e kemi filluar me nje situatë relativisht te mire financiare, detyre e cila kerkon vemendje, kursim dhe menaxhim shume serioz, per te perballuar realizimin e objektiveve te ketij. Viti..

**DREJTORIA E URBANISTIKES :**

**Ka patur si objektiv :**

1. Organizimin e punës per mbylljen e procedurave administrative, per miratimin e Planit te Pergjithshem Rregullues të qytetit;
2. Zbatimin e ligjislacionit te urbanistikës, per ndertimet e reja dhe rikonstruksionet ne institucione e qytetit, infrastrukturen publike dhe sektorin privat, .
3. Realizimin e strategjise se zhvillimit urban dhe menaxhimin e territorit të qytetit.
4. Hartimin e projekteve te zhvillimit, per infrastrukturen publike dhe ndjekja e planit te investimeve, per ndertimet e reja dhe rikonstruksionet ne infrastrukture.

**Nder realizimet e vitit 2011 ne kete drejtori evidentojme :**

1. Kane perfunduar te gjitha fazat teknike te Planit Pergjithshem Rregullues te qytetit dhe eshte miratuar ne KRRT-ne e Bashkise;
2. Jane ndjekur ne te gjitha fazat e tyre, investimet ne infrastrukturen dhe institucionet publike si ndertime te reja dhe rikonstruksione.
3. Miratimin e plote te emertimit te rrugeve dhe shesheve, ne zbatim te reformes se ndermarre nga Qeveria shqiptare, per hartimin e nje sistemi funksional dhe modern te adresave dhe referencave gjeografike ne qytete.

**a. Ne aspektin projektimit dhe investimeve publike:**

Eshte synuar ne hartimin e studimeve urbanistike dhe projektet e zbatimit per infrastrukturen publike ne bashkepunim me njesine e Prokurimit Publik, per prokurimin dhe zbatimin e ketyre projekteve. Keshtu u arriten te pergatiten projekte mjaft cilesore, hartuar nga studio serioze te vendit, te cilët kane krijuar mundesine e prokurimit ne 12 objekte te rendesishme ne infrastrukturen publike duke perfshire te gjitha lagjet e qytetit, investime te cilat po realizohen me financime buxhetore, nga kredia me Raiffeisen Bank dhe nga te ardhurat e Bashkise.

**b. Nder detyrat funksionale te kesaj drejtorie evidentojme :**

1. Ka funksionuar KRRT-ja e Bashkise deri me hyrjen ne fuqi te ligjit Nr. 10 119 datë 23.4.2009 “Per Planifikimin e Territorit”, ne te cilin jane miratuar Plani i Pergjithshem Rregullues, pësë projekte publike dhe disa objekte private.
2. Jane ushtruar dhe mbajtur akte - kontrolli per te gjitha objektet (e pajisura me leje ndertimi) qe jane ne ndertim e siper, sipas fazave te ndertimit.
3. Nga sektori i Kadastres Urbane jane pergatit dosjet per regjistrimin e 80 pronave 60 prej te cileve jane rregjistruar dhe jane ne proces per t’u derguar ne Ryren e Rregjistrimit edhe 200 praktika te tjera.
4. Te ardhurat nga ky sektor jane realizuar ne masen 90,48 %, por me nje vlere prej 11 milion leke me shume nga viti 2010.

Krahasuar/ vite	Te ardhura		%
	Planifikuar	Realizuar	
2010	61 milion	59 573 878	97,7 %
2011	78 milion	70 578 064	90,48 %

Nje aspekt i rendesishem ne punen gjithevjete te kesaj drejtorie ka qene dhe mbetet partneriteti me investitoret privat, krijimin e hapësirave ligjore, per paraqitjen e dokumentacionit teknik te objekteve private e dhenja e pergjigjeve ne afatin qe percakton ligjit Nr. 10119 datë 23.4.2009 “Per Planifikimin e Territorit”.

Ne pervojen e specialisteve te kesaj drejtorie jane krijuar raporte te drejta bashkëpunimi me investitoret privat si dhe jane ndjekur te gjitha fazat e ndertimit te objekteve qe nga piketimi deri ne dhenjen e lejes se shfrytezimit.

Aktualisht duhet vleresuar fakti se hapësirat per ndertime te reja ne Lezhe nga viti ne vit kane ardhur duke u zvogeluar. Ky fakt kushtezon nderprejen e plote te ndertimeve te reja deri ne miratimin e Planit te Pergjithshem Rregullues.

Me hyrjen ne fuqi te ligjit te ri, per planifikimin e territorit dhe miratimin e Planit Rregullues, mjaft detyra specifike e presin stafin e urbanistikes me emertimin e ri qe merr nga ligji si staf i “Planifikimit vendor te Territorit”, ne vitin 2012.



## DREJTORIA E NDIHMES EKONOMIKE & PERKUJDESIT SHOQEROR

### Ka patur si objektiv :

1. Hartimin e projekteve publike me veprim afatshkurter & afatmesëm, për zbutjen e varfërisë, ndihmen ndaj familjeve ne nevoje dhe integrimin e pakicave mbeshtetur ne Strategjine Kombëtare.
2. Evidentimin e familjeve ne nevojë dhe personave me aftësi të kufizuar; brenda territorit të bashkisë, per t'u krijuar mundesite e favorshme dhe ofruar ndihmën e nevojshme ekonomike e shërbimin e duhur social brenda kuadrit ligjor.
3. Bashkëpunimin me shoqata, fondacione dhe sektore homolog, për hartimin e programeve te përbashketa ne ndihme te individeve dhe familjeve ne nevoje, per zbutjen e varferise.

Ne kete drejtori funksionojne dy sektore si :

- a. Sektori i Ndiemes Ekonomike dhe
- b. Sektori i Pekujdesit dhe Sherbimit Shoqeror.

Per **sektori i ndihmes ekonomike**, detyra kryesore ka qene ruajtja e skemes se ndihmes ekonomike ne mbeshtetje te ligjit 9355 date 10.3.2005, pa cenuar perfshirjen e familjeve realisht ne nevoja, pavaresisht nga ana numerike ne raport me vitet e meparshme. Keshtu mund te evidentojme faktin se ne vitin 2011 janë verifikuar **546 familje**, jane intervistuar **574 familje** dhe jane trajtuar me ndihme ekonomike **554 familje** ose 8 familje me shume se vitin 2010.

Nga bashkëpunimi me instiucionet detyruese ne zbatim te akteve nenligjore janë larguar nga skema e Ndihmës Ekonomike **111 familje**, per shkaqe të aresyeshme si punësim, me pjesëtar familje në emigracion, per mosplotësim dokumentacioni etj. Ndersa janë futur në skemën e Ndihmës Ekonomike **125 familje** ne nevoje ose **14 familje** më shumë se viti 2010, me nje **vlere mesatare mujore rreth 2.3 milion leke**.

Rritja e skemës së Ndihmës Ekonomike ne vitin 2011 ka qene e lidhur me faktin se :

- Eshte rritur numri i familjeve te ardhura (22 familje);
- Nga kurora te reja (15), te divorcuar (6); pagesa papunesie (15); te veja (4), jetim (2) e aresye te tjera sociale.

Sipas lagjeve ne krahasim me vitin 2010 kemi kete situatë :

Nr.	Lagja	Numri i familjeve	
		Viti 2010	Viti 2011
1	Skenderbeg	247	240
2	Besdlidhja	103	104
3	Varosh	125	132
4	Nene Tereza	71	78
	<b>Gjithsej</b>	<b>546</b>	<b>554</b>

Siç theksuam edhe me siper nje nga drejtimet e punes te kesaj drejtorie ka qene hartimi i projekteve dhe bashkerendimi me faktore te tjere, per “Kushtezimin e Ndihmës Ekonomike me punë e shërbime në komunitet”. Nga stafi i drejtorise jane evidentuar

1302 persona nga familjet qe trajtohen me ndihme ekonomike te cilet jane te afte per pune e sherbime ne komunitet.

Nga bashkëpunimi me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Zyrën e Administrimit e Menaxhimit të Parkut Arkeologjik- Lezhë për muajt mars - qershor dhe tetor - dhjetor janë përfshirë gjithsej 420 persona ( Familje) me rreth 840 ditë pune sipas objekteve, me natyrë pune si: grumbullimi e pastrimi i bimësie te egër dhe mbetjeve urbane ne zonen arkeologjike ne rreth 240 ha dhe heqje inertesh ne masen 220 m3.

Pjesmarrja në projekt e familjeve të planifikuar është realizuar në masën 93%. Volumi i punës sipas parashikimit është realizuar në masën 82 %.

Projektet e “Kushtëzimit të Ndhmës Ekonomike me punë dhe shërbimet në Komunitet” kete vit (2012) do ketë karakter gjithpërfshirës si në pjesmarrje dhe në zgjidhjen e shumë punëve e shërbime të d.m.d. në komunitin e qytetit.

Ndersa **Sektori i Perkuqjesjes Shoqerore** ka patur si objekt pune :

- Evidentimin me saktësi te subjekteve qe pefitojne ligjerisht perkrahje sociale per paaftesine shendetesore dhe perkusje shoqerore.
- Menaxhimin e fondit akorduar per kete kategori shoqerore ne territorin e Bashkise.
- Bashkëpunimin me institucionet e specializuara qe kane kompetencen, per vleresimin e kesaj kategorie.
- Hartimi i grafikut e ndjekja e rikomisjonimit te dosjeve, si dhe plotesimi i tyre ne kohe me dokumentacionin e nevojshem.
- Kalkulimi i shpejt i pagave e dhenja ne kohe e pageses akorduar nga Min. Punes & Çeshtjeve Sociale.

Edhe gjate vitit 2011 nga ky sektor jane trajtuar 891 veta, me seriozitet dhe performance mjaft cilesore ndaj ketij kontigjent i veçant shoqeror.

Te dhenat e numrit te personave te trajtuar gjate vitit 2011 ne krahasim me ate te vitit 2010 jane sipas tabelës :

Nr.	Emertimi	Te trajtuar sipas viteve	
		viti 2010	viti 2011
1	Para/tetraplegjik	33	34
2	Te verber	56	58
3	Invalid pune	407	450
4	Handikap	246	246
	<b>Gjithsej</b>	<b>742</b>	<b>788</b>

Ketij numri prej 788 veta u shtohen edhe 103 kujdestaret e tyre, per te cilet shteti akordon nje fond mesatar **rreth 5,9 milion leke ne muaj.**

Shtimi i numrit te paaftesise per vitin 2011, konsiston ne faktin se mjaft banore te zones verilindore, kryesisht ish minatorë, jane ç’vendosur nga vendi i tyre dhe jane bërë banorë te qytetit te Lezhes.

Nje aspekt i rendesishem i punes se kesaj drejtoire ka qene sherbimi shoqeror, ndaj familjeve ne nevoje, ndaj grupeve moshave dhe kominiteteve te cilet kane nevoje te

ndjejne mbeshtetjen nga Bashkia. Ne shërbim të tyre janë hartuar projekte dhe është bashkëpunuar me organizata dhe fondacione, si Kryqi Kuq – Dega Lezhe, Karitasi Shqiptar dhe Italin, Korpusin e Paqes, Forca e Drites etj. të cilët kanë mundësuar financimin e tyre për moshën e tretë, shoqatën e jetimeve dhe atë të verberve, për fëmijët e komunitetit Rom etj.

**Objekti** kryesor i punës së kësaj drejtorie për vitin 2012 do mbetet; rritja e efektivitetit të ndihmës ekonomike duke e harmonizuar atë me projekte të “Punëve dhe shërbimeve në komunitet” dhe gjetjen e donatoreve, për bashkëfinancimin e projekteve sociale, në mbeshtetje të minoritetit Rom, Egjiptian dhe familjet në nevojë.

## **DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE:**

**Ka patur si objektiva kryesore :**

1. Rritjen e cilesisë së shërbimit ndaj qytetarëve në të gjitha llojet e shërbimeve publike, të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e sistemit të pastrimit të qytetit, ruajtjes dhe pasurimit të fondit të gjelbërt në qytet dhe kurorën përreth tij, për një qytet të pastër dhe gjithmonë të gjelbëruar;
2. Bashkërendimin e punës me faktorë të tjerë të interesuar në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike dhe përfshirjes së banorëve në monitorimin vlerësimin dhe bashkëqeverisjen komunitare, për implementimin e suksesshem të projektit të grumbullimit e trajtimit të diferencuar të mbetjeve urbane.
3. Vlerësimin si detyrë permanente; mirëmbajtjen e institucioneve publike, rrjetin rrugor, sistemin e kanalizimeve, sinjalistikën rrugore, rrjetin e ndriçimit publik;

**Realizimi i përgjegjesive nga kjo drejtori:**

Drejtorja e shërbimeve publike edhe gjatë vitit 2011 është vlerësuar si një nga drejtoritë me të mëdhenjtë, e cila administron gjithë asetet publike në qytet, që shpenzon shumën më të madhe financiare në kryerjen e shërbimeve publike ndaj qytetarëve.

Me sipërmarrje private, shërbimi i pastrimit mbulon një sipërfaqe prej 104 mijë m<sup>2</sup> rrugë, sheshesh dhe trotuarësh, në 72 pika grumbullimi të mbetjeve urbane, me një vlerë prej 25 milion lekë në vit.

Shërbimi i gjelbërimit realizohet me sipërmarrje private me rreth 12,7 milion lekë / vit, për një sipërfaqe mbi 90 mijë m<sup>2</sup>, ose rreth 14 mijë m<sup>2</sup> më shumë se në vitin 2008.

Spektori më i prekshëm për publikun është **spektori i pastrimit**, ndaj është vlerësuar si prioritet ynë, jo vetëm, në shtimin e sipërfaqeve të pastrimit, në përmirësimin e teknologjisë së pastrimit, apo në financimin e kontratës së sipërmarrjes, por edhe në projekte koherente dhe të zbatueshme.

Kështu tash më është bërë i njohur projekti i mbledhjes së mbeturinave në mënyrë të diferencuar, i pari i këtij lloji në vendin tonë, projekt i cili po gjen mbeshtetje të plotë tek gjithë faktorët e interesit. Mund të themi se ky projekt ka marrë pasaportën e bashkisë Lezhe dhe është mbeshtetur nga strukturat shtetërore në vend, nga të gjitha bashkitë qendër-qarku e më gjere dhe nga donator të ndryshëm si **dldp** (qeverisë

Zvicerane) **Instituti Zhvillimit Urban** me financime nga ambasada e vendeve te Ulta (Hollandeze), te cilet kane ofruar financimin e projekteve ne funksion te tij.

Por, sot pas rreth dy vite qe po zbatojme kete projekt mund te pranojme si te vertete se; zbatimi i ketij projekti nuk mund te realizohet pa ndergjegjesimin e komunitetit lezhjan, gjithë biznesmenet e qytetit dhe grup moshat e ne menyre te veçante nxenesit e shkollave.

Ndonese ne fazen e pare te implementimit te ketij projekt mundesiam nje promocion mediatik dhe konkret ne kamunitet dhe me nxenes te shkollave, sot mund te themi se akoma nuk ia kemi arritur qellimit qe te bindim çdo familje per nje diferencim te mbetjeve qe ne shtepi. Ketij qellimi i vjen ne ndihme edhe projekti i Instituit Urban, i cili ka vetem objektiv sensibilizimin dhe krijimin e bindjeve tek banoret se ky projekt eshte bashkekohor, i realizueshem dhe ne interes te vete qytetareve dhe gjithë shoqerise, per riciklimin e mbetjeve te riciklueshme..

Projekti yne per mbledhjen e diferencar te mbetjeve urbane tashme, mund te themi se ka marre jo vetem miratimin e qytetarise, por edhe legjitimitetin e tij, per faktin se aktet ligjore e nenligjore qe po dalin ne funksion te mbetjeve urbane, kerkojne kete metode mbledhje dhe perpunimi. Kjo na ben te jemi me te vemendshem, per te krijuar te gjitha mundesite dhe hapesirat administrative, per zbatimin e tij ne gjithë ate pjese te qytetit me infrastrukture urbane.

Jo me pak i rendesishem eshte konsideruar **sektori i gjelberimit**.

Per nje qytet bregdetar si Lezha, jane te gjitha mundesite praktike dhe kushtet natyrore per te patur nje qytet gjithëvjetor te gjelberuar, me nje bimesi bregdetare me natyre mesdhetare. Ky fakt ka ndikuar qe ne konceptimin e specialisteve te gjelberimit qe te permiresojne bimesine e gjelbert kryesisht ate drurore qe krahas asaj me gjethe renëse si bliri apo rrapi, nje vend te rendesishme ne dekorimin e gjelbert te zere Palma.

Vetem dy vitet e fundit jane mbjelle tre tipe te veçanta binmesies si Bliri, Palma dhe Kumbulla e Kuqe, bime te cila e kane zbukuruar qytetin tone.

Vetem ditet e fundit bimeise se Blirit (prej 65 rrenje) iu shtuan edhe 100 rrenje te tjera ne aksin e rruges me permasa me te medha e cila po ndertohet perballe Gjimnazit dhe Katedrales.

Vemendje e veçante eshte kushtuar **sektorit te sherbimeve**, si nje sektor i cili miremban institucionet publike dhe krijon premisa pozitive ne zhvillimin normal te gjithë veprimtrise arsimore, kulturore, infrastrukturen publike etj. Nga viti ne vit ky sektor ka patur jo vetem mbeshtetjen tone ne aspektin e plotesimit te nevojave materiale, por edhe ne krijimin e nje koncepti te veçante per rendesine dhe rolin e tij te d.m.d.

Nga te dhenat e fundvitit 2011 rezulton nje shpenzim i Vetem baza materiale e preventivuar per mirembajtjen e institucioneve te qytetit gjate vitit 2011 kap shifrem mbi 2 milion leke te reja.

Ne kete drejtori nuk kane qe ne pa ndikim edhe sektor te tjere te cilet nuk do i kemi objekt analize te hollesishme, pavaresisht nga erendesia qe aat kane si sektori i Sherbimit veterinar, sektori i Dekorimit, sherbimit Funeral etj. Te gjithë keto sektor krijojne ansamblin e pergjithshme te drejtorise sherbimeve, si nje drejtori polivalente per bashkine dhe vete komunitetin.

## **Disa nga problemet e evidentuara ne kete sektor gjate vitit 2011 jane :**

- Ndonese Lezha, sot mund te konsiderohet si nje nder qytete me te pastra ne vend, promocioni me banoret e qytetit, ne funksion te bashkepunimit, per mirembajtjen gjithëvjete te pastertise se çdo mjedisi dhe per te zbatuar realisht projektin tone te Ri, nuk ka realizuar efektiv.
- Nga sipermarrja e gjelberimit nuk eshte arritur te mbahet nje gjelberim gjithëvjetor kryesisht ne periudhen e veres, si rezultat i mungeses se plote te sistemit te vaditjes, si dhe nga demtimet qe vijne nga keqperdorimi i mjediseve te gjelberta kryesisht nga femijet ne blloqet e banimit.
- Sektori i mjedisit duhte te ishte me ekzigjent ne kerkesen per zbatim e ligjit, per mirembajtjen e mjedisit nga vete banoret dhe pastrimin e inerteve te krijuara si rrjedhoje e punimve dhe rikonstrksioneve ne objekte banimi, tregetimi e sherbimi.
- Ndonese dihen kapacitetet e parkimit ne qytet, nje vemendje me e madhe duhej treguar ndaj ketij fenomeni, per te mundesuar stabilizimin e trafikut, kryesisht ne periudhe Piku korrik - gusht.
- Sektori i sherbimeve si gjithnje ka vuajtur nga mungesa e disiplines dhe cilesia e sherbimit, ndaj kete vit duhet menduar per nje zgjidhje me racionale dhe me intersa financiare.

## **DREJTORIA JURIDIKE & PROKURIMEVE PUBLIKE :**

### **Ka patur si detyre :**

1. Të ndikojë ne zbatimin e ligjshmerise ne veprimtarinë e Këshillit të Bashkiak, komisioneve te tij, të Kryetarit të Bashkisë dhe administratës, nepërmjet asistencës juridike;
2. Kontrollin e bazueshmërisë ligjore te aktet administrative (urdhra, vendime, urdhëresa ) që i paraqiten Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë;
3. Te përfaqësojë institucionin e Bashkise, në proceset gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjykimit, kur jemi te paditur ose pale e interesuar;
4. Realizimin e prokurimeve publike, mirembajtjen e dokumentacionit dhe lidhjen e kontratave me sipermarresit.

### ***Si jane realizuar detyrat e ketij sektori :***

#### **a. Ne sektorin Juridik :**

- Ne harkun kohor te 12 muajve te vitit 2011, nga kjo drejtori jane ndjekur 20 çeshtje gjyqesore nga te cilat 14 me objek pronesie dhe 6 per çeshtje administrative.
- Sektori Juridik gjate vitit 2011 ka asistuar 135 akte administrative te konfirmuara nga Kryetari i Bashkise dhe 100 akte te miratuara nga Keshilli Bashkiak.
- Jane zbatuar te gjitha afatet ligjore ne hartimin dhe publikimin e regjistrit te prokurimeve publike per vitin 2011;
- Nga sektori i Prokurimeve Publike jane zhvilluar 13 tendera per mallra, sherbiem dhe investime publike;
- Eshte punuar ne bashkëpunim me USAID, Co Plan e me vone me ATRAKO-s, per zgjidhjen e problemeve te fizibilitetit te Parkut Industrial.

- Ne te gjitha rastet e nevojshme eshte dhene konsulenca juridike drejtorive, si për njohjen e legjislacionit dhe interpretimin e ligjit per rastet konkrete.
- Eshte bashkepunuar me Drejtorine e Burimeve Njerezore, per hartimin e kerkesave per kualifikim ne testimin e organizuar, per pranimin ne sherbimin civil etj.

#### ***Disa probleme te evidentuara ne kete drejtori:***

4. Jo gjithnje jane mbrojtur me kompetence ligjore çeshtjet qe kane patur objekt padie bashkine, praktikat e saj administrative dhe çeshtjet e pronesise, kur ne kemi qene pale e interesuar.
5. Nuk ka patur bashkerendim ndermjet drejtorive, per te sqaruar problematiken qe eshte trajtuar ne gjykate;
6. Ne praktiken e prokurimeve publike, jane konstatuar mjaft mangesi ne plotesimin ne kohe dhe administrimin e dokumentacionit ligjor.

### **DREJTORIA E PROGRAMIM ZHVILLIMIT :**

#### **Ka patur si objektiv te vitit 2011:**

1. Evidentimin dhe perpunimin e indikatorëve te zhvillimit social-ekonomik mbeshtetur ne Strategjiene e zhvillimit miratuar ne vitin 2005;
2. Permireshimin e strategjise se zhvillimit afat shkurter e afatmesem per territorin e qytetit, per vitet 2011 - 2015 ne perputhje me strategjine kombetare te zhvillimit;
3. Hartimin e "Strategjise se zhvillimit te Turizmit" ne qytetin e Lezhes;
4. Bashkëpunimin me donator vendase e të huaja, fundacione dhe shoqata, te cilat shprehin interes, per te bashkepunuar ose investuar ne territorin e Bashkise;
5. Pergatitja dhe afishimi i materialeve promocionale, ne te cilat pasqyrohet puna dhe aktiviteti gjithëvjeter i Bashkise;
6. Azhornimi i faqes se internetit dhe mirembajtrja e logjistikes elektronike te aparatit etj.

#### **Nder realizimet e vitit 2011 nga kjo drejtori evidentojme :**

Viti 2011 duke qene edhe vit elektoral, mund te konsiderohet si viti qe mundesoje promocionin me rael dhe efektiv, per veprimtarine e bashkise, ne kater vite e qeverisjes 2007-2011.

Nepermes fletepalosjeve dhe takimeve publike direkte ose mediatike u realizua nje komunikim i drejtpersedrejt me banoret e qytetit, per t'i njohur me te gjitha arritjet ne aspektin e infrastruktures publike, zhvillimet urbane, ndertime dhe rikonstruksione te institucioneve etj. Ky promocion i veçanre duhet vleresuar jo vetem si nje zgjidhje elektorale, por si nje mundesi dhe pervoje e cila duhet bërë çdo vit dhe per çdo rast.

**Se dyti :** nje nga detyrat me konkrete te kesaj drejtorie ishte dhenja e nje dimensionit te ri Strategjise se Zhvillimit, duke i bërë analize realizimit te projekteve prioritare te strategjise se vitit 2005, per te hartuar perspektivat e zhvillimit afatshkurter & afatmesem 2011-2015.

Edhe ne kete aspekt eshte punuar, qe nga riformulimi i Vizionit te Qytetit ; ku Lezha do te konceptohet si : ***Qytet turistik me trashegimi unike historike dhe kulturore, me ekonomi dhe biznes dinamik, pike lidhje e tregjeve ne rajon, qytet me zhvillim urban e mjedisor te qendrueshem, qe ofron mireqenje per te gjithe.***

Ne funksion te ketij Vizioni, jane hartuar : Qellimet; Objektivat dhe po punohet per hartimin e projekteve prioritare qe do zbatohen nder vite.

**Se treti;** nder detyrat funksionale te kesaj drejtorie ka qene bashkepunimi me donar dhe hartimi i projekteve te zhvillit, per thithjen e fondeve qe mundesojne keto projekte si ato qe financohen nga BE-ja dhe te tjere qe mbeshteten nga qeveri apo fondacione te amerikes dhe europes.

Per vitin 2011 kjo drejtori ka hartuar 6 projekte nga te cilet dy kane filluar nga financimet. Jemi ne bisedime per financimin e projekteve te tjera.

Gjithashtu evidentojme faktin se kjo drejtori ka bere rivleresimin e te dhenave, ne adresen elektronike te bashkise, ka pergatitur disa materiale promocional si: buletini periodik, broshura sensibilizuese, fletepalosje, spote televizive per arritjet e bashkise etj.

### **Ç'fare mund te bëhej me mirë nga stafi i kesaj drejtorie ?;**

- Nje bashkepunim me efektiv me drejtori e sektore te tjere te administrates se bashkise, lidhur me efektivitetin e realizimit te investimeve, si pjese e Strategjise se Zhvillimit te qytetit;
- Racionalizimi i kohes per mbledhjen dhe perpunimin e indikatoreve te zhvillimit duke e vleresuar si faze te rendesishme ne pergatitjen e Strategjise se re te zhvillimit;
- Kembengulja, per krijimin e nje tradite te re ne bashkerendimin e punes ne te gjitha drejtorite, per mbledhjen dhe perpunimin e te dhenave statistikore, si detyrim ligjor, ne evidentimin e zhvillimeve ekonomike dhe sociale te qytetit.

Keto e te tjera detyra, obligojne kete drejtori, per te harmonizuar e kordinuar gjithe problematiken e zhvillimit te qytetit, duke patur ne qender te vemendjes ato objektiva madhore te cilet i kemi hedhur ne komunitet, per te cilet jemi votbesuar Pra, nga analiza e fundvitit 2011 kjo drejtori ka nxjerre perfundimet e saj dhe ka percaktuar drejtimet kryesore te punes per vitin 2012.

## **DREJTORIA E ARSIMIT, TURIZMIT, KULTURES & SPORTEVE**

### **Ka patur si objektiv :**

1. Të sigurojë raporte partneriteti dhe marrëdhënie efektive me gjithë faktorët bashkëpunues per krijimin e kushteve optimale, ne zhvillimin e procesit mesimor, si nje faktor kryesor për ngritjen e cilësisë në sektorin e arsimit;
2. Ngritjen ne nivele bashkëkohore te veprimatrive kulturor e sportive dhe bashkëpunimi me grupet e interesit, komunitetin e biznesit, fondacione, OJF dhe stafet perkatese te ketyre sektoreve, në funksion të rritjes se cilësisë dhe implementimit të projekteve të zhvillimit ne keto sektorë;
3. Koordinimin e punës me institucione shkencore dhe subjekteve te interesuara, per nje pune shkencore permanente ne evidentimin dhe propogandimin e vlerave historike e arkeologjike të zbuluara dhe qe do zbulohen ne te ardhmen, per qytetin antic te Lis-it.

### **Niveli i realizimit :**

Gjate vitit 2011 kjo drejtori ndonese ka patur ndryshime ne stafin e saj, ka bere te gjitha perpjekjet ne vijim te pervojës me te mire, per zgjedhjen e detyrave funksionale duke bere sa ishte e mundur te shmangeshin veshitesite relative qe kane shoqeruar vitin 2011.

Megjithate si pune efektive te vitit 2011 mund te evidentojme :

**Spektori i arsimit** ka patur nje vleresim maksimal, per mirembajtjen dhe plotesimin e nevojave te shkollave, per te mundesuar zhvillimin normal te procesit mesimor.

Keshtu mund te evidentojme faktin se ky sektor ka nje numer prej 6317 nxenes dhe femije kopshti shifre e cila perben rreth 22 % te komuniteti lezhjan, nder te cilet 5744 jane nxenes ne te gjitha nivelert e arsimit dhe dhe 573 femije ne kopshte.

Ndaj vleresimi i ketij kontigjenti ka qene ne nivele maksimale, jo per numrin apo perqindjen qe ze ne raport me banoret e tjere, por si detyrim per brezin me te ri te qytetit i cili ka aq pretendime, per shkollen dhe kulturen, si brezi i cili pergatitet te vazhdoje stafeten e zhvillimeve ne qytetin tone dhe jashte tij.

Spektori i **kultures** e ka patur si objektiv permbushjen e detyres ne aspektin e veprimtrive kulturore, artistike, historike etj. Keto veprimtari jane zhvilluar ne mjediset e ketyre institucioneve si Pallati Kultures, Biblioteka dhe Muzeu i qytetit.

Nder veprimtarite kryesore te ketyre institucioneve per vitin 2011 evidentojme :

**Pallati i Kultures** si institucioni kryesor i kultures ne qytet, per vitin 2011 ka realizuar 45 veprimtari ose mesatarisht 4 ne do muaj me nje pjesmarrje rreth 25 mije spektatore. Keto veprimtari kane patur edhe karakter tradicional siç jane aktivitetet festive ne data te caktuara duke filluar nga 17 janari deri ne naten festive te vitit te Ri.

Gjithashtu, jane bere perpjekje per krijimin e traditave te reja si ne festen me te Re “Netet e Bardha te Kultures Shqiptare”, “Dita e Shtegtareve” etj.

Megjithese numri i veprimtrive te zhvilluara nga pallati i Kultures nuk eshte i vogel, duhet pranuar fakti se niveli i punes i ketij institucioni eshte larg mundesive dhe pretendimeve qe komuniteti lezhjan ka ndaj stafit te ketij institucioni. Ketu nuk perjashtojme edhe gjendjen fizike te pallatit Kultures dhe mungesen e paisjeve per permbushje e detyres se institucionit.

Ndersa **Biblioteka** eshte kthyer nje nder institucionet me te pergjegjshme dhe me te konsoliduara te qytetit. Kjo jo vetem per numrin e veprimtrive gjithvjetore, sa edhe nga cilesia e aktiviteteve dhe frekuentimi i ketij institucioni nga intelektual, te rinje e te reja, veterane, pensionit etj.

Nga viti ne vit , ky institucion po merr permasat e nje institucioni ne nivel qarku. Kjo vjen nga kerkesat qe kane krijuesit dhe intelektualt e qarkut, per te organizuar promovimin e krijimtarise se tyre ne biblioteken e qytetit tone.

Gjate vitit 2011 ne kete institucion :

- jane zhvilluar 62 veprimtari me rreth 4500 pjesemarrës;
- jane promovuar 14 libra, 3 ekspozita e vitrina libri,
- jane marre per tu lexuar mbi 19 mije libra nga te gjitha moshat;
- fondi i librit u rrit me 256 tituj, dhe 571 ekzemplare;

Krahas veprimtrive me te rritur nuk kane munguar as veprimtarite me femije.

Spektori i **Muzeut dhe Memorialit**, ka synuar:



- ne rritjen e cilesise se sherbimit ndaj vizitoreve vendas dhe te huaj, ku numri i vizitoreve per vitin 2011 ka qene mbi 25 mije veta, nder te cilet mbi 3000 kane qene vizitor te huaj;
- bashkepunimin me institucione arkeologjike, per vazhdimin e zbulimeve te reja ne afersi te Memorialit, me qellim rritjen e vlerave te trashegimise historike te qytetit **Antik** te Lis –it.
- Ndjekjen e punes qe behet per zbulimet arkeologjike ne qafen e kalase, ne te cilen jane zbuluar varreza mbi 800 vjeçare dhe 2 Kisha te periudhes se Bizantit etj.

**Spektori i Sportit**, ka patur si objekt kryesor, vazhdimin e tradites ne sportet e njohura te qytetit dhe ngritjen e konsolidimin e sporteve te reja si Boksi, Karate, Xhudo dhe sporti me i ri vitit grupi **aerobi-se**. Ndersa ne sportin me popullor siç eshte Futbollit eshte synuar dalja ne ligen superiore, pretendim te cilin vazhdojme ta kemi edhe kete vit.

Pa shmangur pretendimin kryesor, qe ekipi i futbollit te kaloje ne ligen Superiore, vemendja duhet te perqendrohet tek sportet e reja dhe levizja masive “Sporti per te gjithë” si nje detyrim per rritjen e cilesise sportive dhe talentet e reja.

***Si problemet te evidentuara ne kete sektor jane :***

1. Me gjithë punen e dritanishme ne ndertimin dhe rikonstruksionin e shkollave, akoma jemi ne nje faze kritike, ku mesimi zhvillohet me dy turne dhe mbingarkese ne numrin e nxenesve kryesisht ne Gjimnaz.
2. Krijimi i terreneve sportive te reja dhe rikonstruksioni i atyre ekzistuese, ne funksion te masivizimit dhe rritjes se cilesise sportive, jane probleme te kohes te cilat kerkojne zgjidhje vetem nga ne, si njesi vendore.
3. Gjendja fizike e Pallatit te Kultures eshte larg parametrave optimal te nje institucioni te tille.

**DREJTORIA BURIMEVE NJEREZORE:**

**Ka synuar :**

1. Ne plotesimin e kerkesave baze te punonjesve te aparatit te Bashkise dhe institucioneve vartese, per te mundesuar veprimtarine normale te punes.
2. Ofrimin e punës së administratës së bashkisë me legjislacionin, politikat lokale e rajonale dhe zbatimin e vendimeve të kryetarit dhe Këshillit të Bashkisë ne veprimtarine e çdo punonjesi.
3. Nepermes sektorit te maredhenjeve me publikun, eshte punuar per evidentimin e problemeve te ngritura nga komuniteti dhe venja ne rrugen e zgjidhjes te kerkesave dhe ankesave subjektive te ngritura nga qytetaret;
4. Prezantimin ne media lokale dhe kombetare te arritjeve dhe problemeve qe jane evidentuar ne punen e Bashkise , insitucionet e tjera publike, ne interes te komunitetit lezhjan.

**Disa nga realizimet e kesaj drejtorie evidentojme :**

- Plotesimin e strukturess e personelit dhe nevojat themelore, per mbarëvajtjen e punes se çdo drejtorie .
- Zbatimin e kerkesave te Komisionit Sherbimit Civil dhe vendimin e Keshillit Bashkise, per organizimin e konkursit, per pranimin ne sherbimin civil te administrates se bashkise;
- Kualifikimi i punonjesve te administrates nepermes formave te ndryshme, perfshire bashkepunimin me institucione te specializuara si; Instituti i trajnimeve te Administrates Publike (ITAP), USAID; GTZ; dldp (Intercooperation) etj.,
- Informimin media-tik, nga televizioni publik jane dhene 246 kronika komente dhe biseda direkte, per problematiken e qytetit, pa llogaritur ata lokal.
- Administrimi dhe sistemimi i dokumentacionit arkivor dhe dorezimi i tij sipas etapave ne arkivin e qarkut.
- Nga sektori i maredhenjeve me publikun jane organizuar pritje ditore dhe periodike, per problemet te ndryshme si, per strehim, punesim, ndihme ekonomike, sherbime publike etj. Nga te dhenat e meposhtme rezulton te jete shenuar nje rritje ne numrin e kerkesave dhe ankesave nga banoret ne raport me nje vit me pare.

Konkretisht kemi kete pasqyre te regjistruar per vitin 2011 :

<i>Viti</i>	<i>Kerkesa :</i>	<i>Ankesa</i>	<i>Vertetime</i>
<b>2010</b>	461	333	2 250
<b>2011</b>	840	240	3175
<i>Krabasuar</i>	+ 379	+ 93	+ 925

Takime te rregjistruara ne *pritjet e qytetareve me institucionin e Kryetarit* jane me **1600 persona**.

Jane kthyer pergjigje me shkrim rreth **560 personave** qe kane depozituar kerkesa, ose ankesa te ndryshme.

- Nga sektori i protokollit jane menazhuar **2786 shkresa** ne hyrje dhe **1879 shkresa** te prodhuara nga administrata, sipas tabelës :

<i>Vitet</i>	<i>Shkresa</i>		<i>Vendime/ Kryetarit</i>	<i>Urdhera/ kryetarit</i>
	<i>Hyrje</i>	<i>Dalje</i>		
2010	1224	1387	77	56
<b>2011</b>	<b>2786</b>	<b>1879</b>	<b>64</b>	<b>71</b>
<i>Krabasuar</i>	+ 1562	+ 492	- 13	+ 15

***Si konkluzion:*** Rritja e korespondences zyrtare ne hyrje – dalje, kerkesave, ankesave dhe vertetimeve te ndryshme, mund te vleresohet si nje volum me te madh pune gjate vitit 2011, ndaj nje viti me parë, e lidhur me te qenurit vit elektoral per zgjedhjet vendore.

**Disa probleme qe duhen evidentuar :**

**Se pari :** Me gjithë ndryshimet e realizuara gjatë vitit 2011 në përberjen e administratës së Bashkisë, akoma nuk është krijuar modeli i kërkuar i një nepunesi profesionist dhe intelektual

**Se dyti :** Me gjithë perkushtimin që vërehet nga nepunesit e rinj ardhur nga konkurimi dhe ata që trashëgohet nga administrata e mëparshme, akoma nuk është krijuar stereotipi i raportit të punës në zyrë me atë në terren;

**Se treti :** Mbase nuk është vendi, por vlen të theksohet fakti se tek ndonjë individ i veçantë mungon vullneti për punën dhe detyrimin ndaj taksapaguesit lezhjan.

Ndaj këtyre problemeve duke e marrë në formën e vërejtjes në këto analize, kërkojmë të jete me aktive dhe me kërkuese vetë drejtoria e Burimeve Njerëzore, si promotor i mbarevajtjes së punës në administratë.

## INSPEKTORIATI NDERTIMOR URBANISTIK

Kjo strukturë e cila vepron brenda territorit të Bashkisë ka patur si mision ushtrimin e përgjegjësisë në kontrollin dhe zbatimin e standarteve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës në zbatim të ligjit “Për Inspektimin e Ndërtimit” dhe akteve nenligjore në zbatim të tij.

### Veprimtaria e këtij sektori gjatë vitit 2011 ka synuar :

1. Në mbajtjen nën kontroll të territorit të Bashkisë, në zbatim të planit rregullues të qytetit, në përputhje me legjislacionin urban;
2. Verifikimin dhe kontrollin e çdo procedure të ndjekur nga subjektet që ndertojnë me leje në territorin e Bashkisë;
3. Bashkëpunimin me sektorët e tjere brenda Bashkisë dhe institucionet homologe që ushtrojnë veprimtari ligjore në nivel rajonal e kombëtar;
4. Ndërhyrjen në të gjitha rastet kur janë vërejtur shkelje të ligjit mbi urbanistikën, për parandalimin e ndertimeve pa leje, ose prishjen çdo ndërtimi që bie në kundërshtim me planin rregullues të qytetit.

Krahas aspektit parandalues, në punën e këtij sektori një vend të rëndësishëm ka zënë evidentimi i të gjitha ndertimeve me leje ose pa leje.

Gjatë vitit 2011 inspektoriati ndertimor ka ushtruar aktivitetin e tij në këto aspekte :

- janë kryer 136 Proces Verbale konstatimi për ligjshmërinë e ndërtimit;
- janë bërë 122 Vendime Prishje;
- janë bërë 80 Proces Verbale Ekzekutimi nga të cilat janë në proces ekzekutimi 20 Vendime;
- Është kontrolluar zbatimi i ligjshmerisë në të gjitha objektet e paisura me leje ndërtimi nga KRRT-ja e Bashkisë;
- janë kontrolluar 10 (dhjetë) subjekte ndërtuese nga të cilat 6 prej tyre zbatohen projekte në investimet publike;
- janë evidentuar objektet e ndërtuara pa leje në territorin e Bashkisë, me prioritet ndërtimet në Parkun Arkeologjik.

Ky angazhim ka krijuar mundësi për mbajtjen nën kontroll të situatës ndertimore në qytet.

Duke vlerësuar faktin se ky sektor përballë gjithnjë me kundravajtje, veprime antiligjore dhe konflikte interesi me banorë dhe ndertues, për vitin 2012 objekt kryesor në punë

etij do jete, parandalimi i ndertimive duke nderhyre me shume force qe ne momentet e para te punimeve, pa pritur avancimin e puneimeve apo ndertimin e plote te objektit. Kjo praktike eshte e vetmja mundesi te shmangim ndertimet pa leje dhe shpenzimet pa kriter te qytetareve.

## **POLICIA BASHKIAKE**

Ne përberje te se ciles jane 7 veta me nje mision te rendesishem ne Bashki, si institucion i zbatimit te akteve administrative dhe mbeshtetje ne te gjithë praktikat ligjore, te sektoreve te tjere.

Nder detyrat kryesore te realizuara nga Policise Bashkiake kane qene :

- Kryerja e sherbimeve ne funksion te ruajtjes se rendit, qetesise dhe mbarevajtjes se jetes ne qytet;
- Zbatimin e akteve te nxjerra nga Kryetari dhe Keshilli i Bashkise, kur ata kane te bëjne me rendin, qetesine, sigurimit te ardhurave vendorem, lirimim e mjedisve publike etj.
- Kerkesa e vazhdueshme, per respektimin e dispozitave ligjore, te cilat rregullojne veprimtarine e shitblerjeve ne mjedisve publike dhe respektimin e rregullave te tregut etj.
- Parandalimin e ndotjeve te mjedisit nga subjekte private apo publike dhe marrjen e masave per vendosjen e situatave normale ne qytet;
- Zbatimin e rregullave te Kodit Rrugor ne aspektin e parkimit te automjeteve private ne akset kryesore te qytetit deh jashte vendeve te miratuara nga Bashkia etj.

Krahas ketyre detyrave nje vend te rendesishem ne punen e Policise Bashkiake ka zene mbeshtetja ndaj drejtorise Tatim Taksave, per realizimin e te ardhurave vendore dhe Inspektoriatin Ndertimor, per pezullimin e ndertimeve te paligjshme dhe shembjen e objekteve paleje, per t'i hapur rruge investimeve publike.

Nder aspektet e punes se perditshme te policise ka qene kontrolli i vazhdueshem per lirimim e hapësirave publike si nga zenja e lokaleve ne afersi te trotuareve dhe nga tregu ambulant i cili ka qene i pranishem cdo dite.

Nje vend te rendesishem ka zene kontrolli i perditetshem, gjobitja dhe largimi I makinave te parkuara ne kundërshtim me rregullat e “Kodit Rrugor”, per disiplinimin e trafikut, ndonese kompetencat e cinguara te policise bashkiake ne kete drejtim.

Numri i gjobave te vena per vitin 2011 ka qene **421 gjoba** me vlere **428 000 leke**.

Por krahas angazhimeve jane verejtur edhe veshtiresi ne kryerjen e detyers nder te cilat evidentome :

1. Mangesite e ligjit, per kompetencat e policise bashkiake ne qytete si Lezhe, kryesisht ne aspektin e qarkullimit dhe mungesa e bashkepunimit me sektorin e policise se qarkullimit rrugor.
2. Mangesi ne bashkerendimin me struktura te tjera te Bashkise, ne mbeshtetje te kerkesave per zbatimin e akteve administrative dhe detyrimeve ligjore.
3. Mungese bashkepunimi me strukturat e policise rendit, kryesisht me ate te qarkullimit rrugor;
4. Mangesi ne aspektin e akomodimit te policise, kryesisht gjendja jo e mire e automjetit te Policise Bashkiake;

5. Puna me orë te zgjatura ne shtate ditet e javes pa pushim;
6. Disiplina e punes dhe kultura gjate kryerjes se sherbimit nuk ka qene gjithnje ne lartesine e duhur, me norma qytetarie dhe kodin e etikes se policit.

Keto kane qene disa mangesi dhe veshtiresi me te cilat eshte perballur puna e Policise Bashkiake. E rendesishme mbetet, jo vetem evidentimi i tyre, por reflektimi ndaj mangesive te konstatuara dhe permiresimi i punes ne vitin 2012.

## **ZYRA E GJENDJES CIVILE:**

### **Si funksion i deleguar me nje staf prej dy vetash ka patur si mision :**

1. Te realizoje nje sherbim te shpejte dhe te kulturuar ndaj qytetareve, per te krijuar nje performance te mire ne komunitetin lezhjan.
2. Per te qene aktiv ne zbatim te kerkesave te reja ligjore, per kompjuterizimin e sherbimit te Gjendjes Civile dhe perditesimin e Rregjistrimit Kombetar te Gjendjes Civile.
3. Zbatimin e kerkesave te ligjit, per saktesine e listave zgjedhore ne zgjedhjet vendore te 8 majit 2011 dhe perballimi i fushates me te gjitha elementet e saj .
4. Bashkëpunimi me zyrat homologe te njesive vendore, me instirucionet e tjera te rrethit dhe kompanine e prodhimit te pasaportave Biometrike etj.

### **Nder arritjet e vitit evidentojme :**

- Si prioritet i kesaj zyra ka qene pergjegjesia ndaj ligjit ne hartimin e listave zgjedhore dhe korektesia ndaj kerkesave te forcave politike, ne te gjitha etapat zgjedhore.
- Perditesimi me korektesi i Rregjistrimit Kombetar te zgjedhjeve, per te menjanuar çdo pretendim te forcave politike ne fazen parazgjedhore.
- Krijimin e kushteve te punes dhe implemtimi i projektit, per leternjoftimet e reja dhe pasaportat Biometrike.
- Ndryshimet demografike te regjistruara per vitin 2011 jane si me poshte :
  - a. Banor      2,7 % me shume ose      + 770 veta
  - b. Lindje      8,6 % me pak ose                - 13 lindje;
  - c. Vdekje      21 % me shume ose                + 18 vdekje
  - d. Maertesa 21 % me shume ose                + 31 martesa.

Siç del nga te dhenat qe trajtuam me siper dhe tabela krahasuese e afishuar me poshte rezulton se Lezhe po rritet nga viti ne vit nga ana numerike dhe njekohesisht edhe ne siperfaqe urbane.

Mund te evidentojme faktin se : po vazhdon e njejta menyre rritje siç ka ndodhur ne dy dekadat e fundit ku rritja natyrore eshte me vogel se ardhjet nga zonat e tjera te rrethit apo jashte tij.

Po te bejme nje llogaritje te thjeshte rezulton qe rritja natyrore eshte vetem 0,67 %, ndersa ajo mekanike eshte 2 %.

Vitet	Popullsia	meshkuj	femra	familje	lindje	vdekje	martesa
viti 2010	28 232	13 828	14 404	7648	208	85	145
<b>viti 2011</b>	<b>29002</b>	<b>14 150</b>	<b>14 852</b>	<b>7 972</b>	195	103	176

Shtesa	+ 770	+ 322	+ 448	+ 324	- 13	+ 18	+ 31
--------	-------	-------	-------	-------	------	------	------

Ndersa si proiritet te Gjendjes Civile per vitin 2012 evidentojme :

- a. Persosjen e sherbimit ndaj qytetareve dhe;
- c. Vendosja e sistemit te adresave ne bashkepunim me Drejtorine e Urbanistikes se Bashkise dhe Drejtorine Rajonale te Postave.

Objektivi me madhor, per vitin 2012 eshte "Rritja e cilesise se jetes qytetareve" e cila do te mundesohet nepermes ketyre rrugeve :

1. Rritjes se cilesise se sherbimeve publike;
2. Permiresimit te infrastruktures ne qytet;
3. Nxitjen dhe mbeshtetjen e biznesit te mesem dhe te vogel, per rritjen e te ardhurave dhe punesimin e banoreve te qytetit;
4. Gjetja e donatoreve, per zhvillimin e Parkut Industrial,
5. Rritjen e siperfaqeve te gjelberta dhe permiresimi i atyre ekzistuese;
6. Ndertimin dhe venja ne funksion e dy shkollave te reja dhe rikonstruksionin e shkolles "Kosova";
7. Lezha qytet Universitar, duke i siguruar te rinjet lezhjan edhe nepermes kesaj analize qe nisma jone do behet realitet;
8. Do vazhdojme punen e nisur, per reformimin e vazhdueshme te administrates, nepermes konkurimit te aftesive dhe vlerave profesioanle e administrative, duke vene ne plan te pare te rinjet qe shkollohen me rezultate te mira ne shkollat shqiptare dhe jashte vendit.

### **Te nderuar pjesemarres !**

Me arritjet e deritanishme dhe sigurine per pune akoma me te vyera ne vitin qe sapo kemi filluar, me angazhimin maksimal te burimeve njerezore dhe intelektuale, administrata e Bashkise, do krijojte premisa te besueshme, per.....

- Avancimin e vizionit tone ne lartesite e kerkesave te kohes, per te marre nisma te reja ambicioze, ne hartimin dhe implementimin e projekteve me rendesi zhvillimi per te ardhmen e qytetit;
- Per t'u vene gjithnje e me mire ne sherbim te komunitetit qytetar, ne funksion te rritjes se nivelit dhe cilesise se jetes tyre;
- Per te mundesuar hapisira te reja arsimimi dhe zhvillimi per brezin e ri;
- Per krijimin e mundesive per nje bashkejetese qytetare te te gjitha grup moshave, etnive dhe besimeve fetare si nje detyrim i perhershem, ndaj qytetarise lezhjane.

### **Si perfundim :**

Nga ky material modest u perpoqem te japin nje pasqyre te punes se bashkise per vitin 2011 dhe disa nga drejtimet e punes per vitin 2012.

Duke njohur me pergjegjesi mangesive tona te konstatuara gjate vitit 2011, do jemi me te vemendshem dhe kembengules ne permiresimin e metodologjise se punes dhe veprimatrise se gjithshme te administrates se bashkise per vitin 2012.

**Faleminderit per vemendjen.**

**VIKTOR TUSHAJ**  
**Kryetari i Bashkise**

*Lezhe, me 01.02.2012*